



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2019:148212

Datë: 19.07.2019

Numri i dokumentit: 00418062

PKR.nr. 102/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, si gjykatë e shkallës së parë penale, me kryetarin e trupit gjykues Sahit Krasniqi, si dhe me sekretaren juridike Adelina Sallahu, në çështjen penale kundër të pandehurit S.V., për shkak të veprës penale përdorimi i armës apo i mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 KPRK-së, dhe veprës penale mbajtja në pronësi, në kontroll, ose në posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës PPI.104/19 të dt. 11.07.2019, në praninë e përf. të akuzës-prokurorit të shtetit Ismet Rrahmani, të pandehurit S.V., pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik më dt.19.07.2019 morri dhe publikisht shpalli këtë :

A K T G J Y K I M

I pandehuri S.V., i lindur me datënë fsh. G. K. Ferizaj, nga i ati Sh. dhe e ëma N., e vajzërisë B., me vendbanim në fsh. G. K. Ferizaj, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, ka të kryer shkollën fillore, i pa martuar, i gjednjes së mesme ekonomike, punon në parking të veturave, me numër personal, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

I.

Sepse: me datë 04.07.2019, rreth orës 03:35, në kafenen e musikës “B.....”, e cila gjendet nëmaxhistralen Kaçanik – Ferizaj, i pandehuri ka përdorur revolen e tipit “TT M57”, të

kalibrit 7.62mm, ngjyrë e zezë, në atë mënyrë që derisa ka qenë duke qëndruar në lokalit në fjalë, së bashku edhe me një shokë të tij, në një moment i pandehuri ka nxjerrë nga çanata e tij e dorës revolen e lartëpërmendur, ku me të njëjtën ka shtënë në ajër, saktësisht në tavan të lokalit,

- **Me çka ka kryer veprën penale përdorimi i armës apo i mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 te KPRK-së.**

II.

Sepse: nga data e pa përcaktuar deri me dt. 04.07.2019, ne Ferizaj, saktësisht në kabinën e qëndrimit ditor të biznesit të tij “.....”, ka mbajtur në posedim pa leje dhe të pa autorizim përkatës, armën e tipit “TT M57”, të kalibrit 7.62 mm, ngjyrë e zezë, me numër serik 127870, me një karikator me 8/tetë/ fishek si dhe një thikë të vogël, ngjyrëtë zezë, ku pas një kontrolli të kryer nga ana e policisë, arma dhe thika në fjalë të pandehurit i janë konfiskuar .

- **Me çka ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së**

Andaj gjykata në bazë të dispozitave të përmendura dhe nenit 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 46, 47, 48, 49, 69, 70, 71, par.1 nenpar. 1.2 dhe 1.3 të KPRK-së si dhe nenin 365 të KPRK-së të pandehurit i

CAKTON

Per veprën penale “përdorimi armës apo i mjetit të rrezikshëm” nga neni 367 par.1 te KPRK-se, te përshkruar ne **dispozitivin I** te aktakuzes i caktoi dënim burigimi ne kohëzgjatje prej **1/një/ viti**, i cili nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën kohore prej **1 /një/ vite** nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.

Per veprën penale “mbajtja ne pronësi, ne kontrollë ose ne posedim te pa autorizuar te armeve” nga neni 366 par.1 te KPRK-se, te përshkruar **ne dispozitivin II** te aktakuzës, i caktoi dënim me gjobe ne lartësi peregj **300/treqind/ euro**.

Ne baze te nenit 76 par. 2 nënpar. 2.5 te KPRK-se, te akuzuarin e :

G J Y K O N

Me DËNIM UNIK burgimi ne kohëzgjatje prej **1/një/viti**, i cili nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën kohore prej **1 /një/ vite** nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi nuk kryen veprë tjetër penale dhe **Denim me gjobe** ne lartësi prej **300/treqind/euro**, të cilin dënim i pandehuri është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi i shqiptuar me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyrat tjera të parapara me nenin 46 par.3 të KPK-së do të ekzekutohet në atë mënyrë që për çdo 20 euro i pandehuri do të vuajë nga një ditë burgu.

Konform nenit 366 par.3 te KPRK-së, konfiskohen ne menyre te përhershme , arma e tipit “TT M57”, të kalibrit 7.62 mm, ngjyrë e zezë, me numër serik 127870, me një karikator me 8/tetë/ fishek si dhe thika e vogël, ngjyrëtë zezë.

Obligohet i akuzuari që në emër te shpenzimeve te procedurës penale te paguaj shumen prej 30 (tridhjet) euro dhe ne emër te paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30/tridhjet/euro, si dhe të paguaj shumen prej 50/pesëdhjetë/euro në Fondin për Kompensimin e Viktimave të Dhunës, te gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pasi aktgjykimi të merr formën e prerë.

A r s y e t i m i

- Historiku i procedurës

Prokuroria e Themelore në Ferizaj-Departamenti për Krime të Rënda me aktakuzën PP.I.nr.104/19 të dt.11.07.2019 ka ngarkuar të pandehurin S.V. për shkak të veprës penale përdorimi i armës nga neni 367 par.1 të KPRK-së dhe veprës penale mbajtja ne pronësi, kontroll, ose posedim te pa autorizuar te armeve nga neni 366 par.1 te KPRK-se.

Kryetari i trupit gjykues duke vepruar në këtë çështje penale, sipas dispozitave të nenit 245 të KPPK-së, mbajti seancën e shqyrtimit fillestar më dt. 19.07.2019, në të cilën Prokurori i Shtetit Ismet Rrahmani ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë aktakuzës dhe kualifikimit juridik të veprave penale përdorimi i armës apo i mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-se, dhe mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-se, duke propozuar që të pandehurit të i pranohet fajësia dhe të i shqiptohet dënimi i paraparë me ligj.

- **Deklarimi i të pandehurit për fajësinë**

Në seancën e shqyrtimit fillestar me rastin e dhënies së mundësisë për të u deklaruar lidhur me fajësinë, i pandehuri S.V. ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprat penale për të cilat e ngarkon aktakuza në të gjitha pikat e saj duke shtuar se është penduar thellë për kryerjen e këtyre veprave penale dhe i premtun gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryen vepra të tilla apo të ngjashme penale.

- **Vlerësimi i pranimin të fajësisë**

Pasi që i pandehuri ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës , Kryetari i trupit gjykues në shqyrtimin fillestar vlerëson se:

- i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë,
- pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht nga i pandehuri.
- pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, dhe në provat tjera të cilat gjenden në shkresat e lëndës siç janë: deklarimi i të pandehurit, deklarimet e dëshmitarëve, raporti fillestar i incidentit, vërtetimi mbi konfiskimin e sendeve dhe fotografit të cilat gjenden në shkresat e lëndës.
- Aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime tjera faktike.

- **Analiza e ligjit material**

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit **S.V.** ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-se dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të pa autorizuar të armeve nga neni 366 par.1 të KPRK-se.

- **Përcaktimi i dënimit**

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, si rrethanë veçanërisht lehtësuese për të pandehurin mori pranimin e fajësisë, ndërsa si rrethana lehtësuese mori se nuk ekzistojnë të dhëna se më parë i pandehuri ka qenë i dënuar për ndonjë veprë penale, është penduar thellë dhe është zotuar se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra të tilla penale, sjelljen korrekte gjatë procedurës, gjykata duke marrë parasysh këto rrethana, konform nenit 71 par.1 nenpar.1.2 dhe 1.3 të KPRK-se aplikoi institutin e zbutjes së dënimit dhe të pandehurit **i shqiptoj DËNIM UNIK burgimi** në kohëzgjatje prej **1/një/viti**, i cili nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën kohore prej **1 /një/ vite** nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi nuk kryen veprë tjetër penale dhe **Denim me gjobe** në lartësi prej **300/treqind/euro**, të cilën gjobë dot ta aguar në afatin prej 15 dite pasi aktgjykimi të merre formën e prerë. Sipas bindjes së gjykatës ky dënim është plotësisht i justifikueshm në raport me peshën konkrete të veprave penale, shkallën e përgjithësisë penale të të pandehurit, rrethanave të kryerjes së veprave penale, me të cilin dënim do të arrihet qëllimi ndëshkues në kuptim të nenit 38 të KPRK-së, që të njëjtin ta parandalojë nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, si dhe të përmbajë persona të tjerë nga kryerja e veprave penale.

Konform nenit 366 par.3 të KPRK-së, konfiskohen në menyre të përhershme , arma e tipit “TT M57”, të kalibrit 7.62 mm, ngjyrë e zezë, me numër serik 127870, me një karikator me 8/tetë/ fishek si dhe thika e vogël, ngjyrë e zezë.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguar shumën prej 20 (njetzet) euro dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguar shumën prej 30/tridhjet/euro, si dhe të paguar shumën prej 50/pesëdhjetë/euro në Fondin për Kompensimin e Viktimave të Dhunës, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pasi aktgjykimi të merr formën e prerë.

Nga arsyet e lartë përmendura është vendos si në diapozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
PKR.nr.102/19 dt. 19.07.2019.

Sek.juridike

Adelina Sallahu

Kryetari i trupit gjykues

Sahit Krasniqi

KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa

Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej

15 ditësh nga dita e pranimi të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, për mes

kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2019:148212
Datë: 19.07.2019
Numri i dokumentit: 00418062